



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:052059  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05865377

Ac.nr.1093/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.Z nga Gj....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.M avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M, zyrtar i lartë ligjor në Komunën e Gjilanit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1091/2020 i datës 25.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 19.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1091/2020 i datës 25.11.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1091/2020 i datës 25.11.2021, ka vendosur: *‘I. Aprovohet në tërësi e bazuar, kërkesëpadia e paditëses M.Z nga Gj....., dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar (në vlerë të një page baze) t’ia paguaj shumën prej 459.00 €, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë t’ia paguaj shumën prej 936.00 €, me kamatë ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga data 14.04.2020, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit.*

*II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses M.Z nga Gj..... t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 270 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi''.*

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje ose ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësja përmes të autorizuarit të saj duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjta të refuzohet si pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës me datë 14.04.2020, si dhe me precizimin e kërkesëpadiës përmes parashtresës së datës 28.10.2021 ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura, që paditëses që për 30 vite përvojë pune, të detyrohet e paditura, t'ia paguaj shpërblimin jubilar në shumën prej 459 €, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë për periudhën prej datës 18.04.2017 deri më datë 21.06.2021, për 468, ditë të pranisë në punë t'ia paguaj shumën prej 936 €, me kamatë ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga data 14.04.2020, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe ndryshimit të saj, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe atyre të nxjerra në seancën e shqyrtimit kryesor, si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1091/2020 i datës 25.11.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të provave të administruara dhe gjendjes faktike të provuar, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, pasi që gjykata ka provuar faktin se: nga Kontrata e punës nr.1926 e datës 01.09.2016, e lidhur në mes të paditëses si punëmarrës dhe të paditurës si punëdhënëse, gjykata provoj faktin se paditësja me të paditurën kanë nënshkruar kontratë pune në kohë të pacaktuar, në Institucionin arsimor SH.M.E, ".....", në Gj....., në titullin e punës mësimdhënëse e lëndëve ekonomike, me 20 orë mësimore në javë. Nga Vërtetimi me nr. protokolli me nr. 55. i datës 13.03.2020, i lëshuar SH.M.E ".....", në Gjilan,

gjkata e vërtetoi faktin se paditësja, ka marrëdhënie pune prej 01.09.1988, e më tutje, ndërsa përvojë të punës ka 31 vite e 7 muaj. Nga formulari për kërkesë apo ankesë me nr. të protokollit.05/610/01-0029354/20 e dt.17.03.2020, dhe kërkesa drejtuar DKA-as në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se i njëjta fillimisht i është drejtuar të paditurës në procedurë administrative për kompensim të ushqimit në punë dhe pagës jubilarë. Nga Lista e pagave nga buxheti i RKS-se, në emër të paditëses me nr.EM00014860, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka pagën bazë 459 €. Nga vërtetimi me nr.55, dt.14.10.2020, i lëshuar nga SHME. “.....” gjykata vërtetoi faktin se paditësja nga data 18.04.2017 deri më datën 11.03.2020, ka gjithsejtë 356 ditë pune. Nga Vërtetimi me nr. 241, dt.28.10.2021, i lëshuar nga SHME. “.....” gjykata vërtetoi faktin se nga data 14.09.2020 deri më datë 16.04.2021, e njëjta ka qenë në punë 112 ditë pune, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura më lart, përkatësisht nenit 35 paragraf 7 të KKAK-së, gjeti se paditësja i takon e drejta që për ditët e pranishme në punë t’i kompensohet shuma prej nga 2 € në ditë për ushqim gjatë ditëve në punë, edhe atë për 468 ditë të pranishme në punë, të llogaritur nga 2 € për një ditë pune i takon shuma prej 936 €. Po ashtu, gjykata duke bazuar në nenin 35 paragrafi 8 pika 8.3 të KKAK-së, gjeti se paditësja i takon e drejta e kompensimit për shpërblimin jubilar në vlerë të 100% të një page baze për shkak të përvojës së punës mbi 30 vite, andaj duke llogaritur pagën bazë në shumë prej 459 € me 100 % të vlerës së saj, rezultoi se paditësja i takon e drejta për shpërblim jubilar për lartësinë e aprovuar në shumë prej 459 €.

Për bazën juridike i është referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, lidhur me kamatën iu referuar nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës iu referua nenit 449, 452 dhe 463.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), se nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, nuk ka paraqitur qartë se cilat arsye i trajton si të vërteta apo të pavërteta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendimet të autorizuarit të të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësja i takon e drejta në vlerën 100 % të një page baze në emër të shpërblimit jubilar në shumën e gjykuar, ngase është vërtetuar se e njëjta është e punësuar tek punëdhënësi mbi 30 vite dhe 30 vite të përvojës së punës i ka përmbushur në vitin 2019 brenda

kohës së fuqisë së Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilës parashihet se: mbi 30 vite përvojë pune punëmarrësit i takon shpërblimi jubilar në vlerë të 100 % të një page bazë, ndërsa lartësia e pagës së paditëses është vërtetuar nga lista e pagave të realizuara nga paditësja.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblim jubilar dhe kompensim për ushqim në ditët e pranisë në punës për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18.04.2017, përcaktohet se: *“punëtorët (anëtar të SBASH-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një pagë bazë, për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vite të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë”*. Ndërsa nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se: *“ Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimi për një ditë të pranisë në punë është 2 €, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë formë tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Andaj, për kompensimin e pagës jubilarë drejtë është vendosur shuma prej 459 €, si dhe për vlerën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për 468 ditë të punës, me të drejtë iu është njohur shuma prej 936 €, e gjithsej shuma prej 1.395 €.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës dhe pagës jubilarë për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për

kompensim ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit për ditët e pranisë në punë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunitet - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se paditësja nuk i ka 30 vite përvojë pune, nuk qëndron pasi që bazuar në vërtetimin nr.55 të dt.13.03.2020, shihet qartë se paditësja ka filluar punën në vitin 1988, e që nga 01.09.1988 e deri në datën e ndryshimit objektiv të kërkesëpadisë me dt. 28.10.2021, paditësja ka mbi 30 vite përvojë pune.

Lidhur me pretendimin ankimor të paditurës se kemi parashkrim të kërkesës së paditësës për shpërblim jubilar, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, me arsyetimin se paditësja ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare dhe se ende vazhdon të realizojë aktivitetin punues në kuadër të SH.M.E “.....”, andaj duke pasur parasysh se Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017, kurse paditësja padinë e ka ushtruar me dt. 14.04.2020, pra brenda afatit kohor të paraparë me ligj, respektivisht me nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili shprehimist parasheh se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj rezulton se padia e paditësës është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësës nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese, nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i mori parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1093/2022, me datë 19.06.2024

Kryetarja e kolegjit  
Nora Bllaca-Dula, d.v.